



Pranuar / Dorezuar Prijeno / Prodato Received / Delivery	29.12.2023	viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPJENSK	7762/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1377/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Sabile Avdyli në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1377/2023 të datës 03.11.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

kundër organit të punësimit Komisioni i Pavarur për Media, në çështjen juridike „kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim më datën 29.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1377/2023 e datës 03.11.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër reference Nr.ref.2310/970/EXD/fr i datës 23.10.2023 i Zëvendësuesit të Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i emëruar sipas Vendimit me numër reference Nr.ref.1909/1054/KP/mf të datës 16.09.2019 të Kryetarit të Komisionit të Pavarur të Mediave në pozitën e punës „Kryeshef Ekzekutiv” në kuadër të Komisionit të Pavarur për Media, më datë 23.10.2023 Zëvendësuesi i Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur të Mediave ka nxjerrë Vendimin me numër reference Nr.ref. 2310/970/EXD/fr përmes së cilit ankuesin e ka pezulluar përkohësisht nga lista e pagave, deri një përgjigje zyrtare të institucioneve kompetente lidhur me mandatin e tij.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër reference Nr.ref.2310/970/EXD/fr të datës 23.10.2023 të Zëvendësuesit të Kryeshefit Ekzekutiv në Komisionin e Pavarur për Media, më datë 03.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6866/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor sepse me Vendimin e

atakuar me ankesë është vendosur çështja e cila është „RES JURIDICATA si dhe Vendimi përmban shkelje thelbësore të dispozitave procedurale si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 03.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komisioni i Pavarur për Media. Ndërsa Këshilli më datë 06.12.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë e cila është protokolluar me numër protokolli Nr.prot.1377/2023 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6866/2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër reference Nr.ref. 2310/970/EXD/fr të datës 23.10.2023 të lëshuar nga Zëvendësuesi i Kryeshefit Ekzekutiv; Kërkesën për anulimin e Vendimit me numër reference Nr.ref.2310/970/fr të datës 31.10.2023; E-mailin e datës 31.10.2023 nga drejtuari Vendimin me numër reference Nr.ref.1909/1054/KPM/mf të datës 16.09.2019 të lëshuar nga Kryetari i Komisionit të Pavarur për Media; Vendimin me numër reference Nr.ref. 2112/1460/KPM/xh.P të datës 15.12.2023 lëshuar nga Kryetari i Komisionit të Pavarur për Media; Vendimin me numër reference Nr.ref 2107/771/KPM/xh.2 lëshuar nga Kryetari i Komisionit të Pavarur për Media; Vendimin me numër A.nr.1212/2021 të datës 07.02.2022 të lëshuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në padi lidhur me Vendimin e Këshillit A.nr.1212/2021 me numër protokolli 7479/2023 të datës 29.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të datës 03.11.2023; Përgjigjen në ankesën e ankuesit me numër protokolli 1377/2023 të datës 07.11.2023; Konkursin të shpallur nga Ministria e Administratës Publike për titullin e vendit të punës „Kryeshef Ekzekutiv“; Procesverbalin e mbledhjes së nëntë të Komisionit të Pavarur të Mediave të datës 29.08.2019; Listën e pagave për muajin shtator 2023; Listën e pagave për muajin tetor 2023; Listën e pagave për muajin gusht 2023; Listën e pagave për muajin korrik 2023.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesi dhe organi i punësimit dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesi në bazë të Vendimit me numër reference Nr.ref.1909/1054/KPM/mf të datës 16.09.2019 të nxjerr nga Kryetari i Komisionit të Pavarur të Mediave, është emëruar në pozitën Kryeshef Ekzekutiv në kuadër të Komisionit të Pavarur për Media për një mandat katër (4) vjeçar.

Tutje, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Kryetari i KPM-së, me datë 02.07.2021 ka nxjerr Vendimin me numër Ref:2107/771/KPM/xh.1 përmes të cilit ka pezulluar ankuesin nga ushtrimi i detyrës me kompensim 50 të pagës, deri në një vendim tjetër, me arsyetimin se ndaj të njëjtit është iniciuar procedurë penale dhe është shqiptuar masa e paraburgimit.

OVO
BORBY
310 . 5

Ankuesi, me datë 25.11.2021 i është drejtuar me kërkesë Kryetarit të KPM-së, për anulimin e Ref:2107/771/KPM/xh.l të datës 02.07.2021 për pezullim parandalues dhe i njëjti ka kërkuar të kthehet në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, me arsyetimin se me datë 22.11.2021 i ka përfunduar masa e arrestit shtëpiak dhe se gjykata kompetente nuk ka lëshuar ndonjë mase tjetër e cila do të kufizonte lirin e lëvizjes.

Me datë 15.12.2021 KPM ka nxjerr Vendimin me numër Ref.2112/1460/KPM/xh.l me të cilin ankuesit i është vazhduar masa e pezullimit të ushtrimit të detyrave me të drejtën e kompensimit në pagë në lartësi pre 50% të pagës me arsyetimin se ende nuk janë plotësuar kushtet ligjore që të anulohet vendimi për pezullim parandalues për faktin se ndaj palës është duke u zhvilluar procedurë penale.

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr.Ref.2112/1460/KPM/xh.l të datës 15.12.2021 të KPM-së, me datë 23.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër A.nr.1212/2021 të datës 07.02.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit, dhe ka lënë në fuqi Vendimin me Nr. Ref.2112/1460/KMP/xh. të datës 15.12.2021 për pezullim me 50% të pagës.

Zëvendësuesi i Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur të Mediave më datë 23.10.2023 ka nxjerrë Vendimin me numër reference Nr.ref. 2310/970/EXD/fr përmes së cilit ankuesin e ka pezulluar përkohësisht nga lista e pagave, deri një përgjigje zyrtare të institucioneve kompetente lidhur me mandatin e tij.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër reference Nr.ref.2310/970/EXD/fr të datës 23.10.2023 të Zëvendësuesit të Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media, pretendon se vendimi është i kundërligjshëm për shkak se nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë juridikë sepse kemi Vendimin A.nr.1212/2021 të Këshillit i cili ka lënë në fuqi vendimin për pezullim me 50% të pagesë deri në vendimin përfundimtar gjyqësor dhe edhe në këtë proces nuk kemi vendim përfundimtar të gjykatës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Aktgjykimin në rastin Nr.KO203/19 me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe si rrjedhojë ka gjetur së Gjykata Kushtetuese në pikën III të aktgjykimit ka konstatuar se: *Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokuroria të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese; Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë.* Ndërsa në pikën II të këtij aktgjykimi është konstatuar se neni 85 i Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk është në përputhshmëri me nenin 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave] të Kushtetutës. Andaj, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një lëndë të mëhershme që ndërlidhet me Ligjin e aplikuar në këtë periudhë Nr.03/L-149

për Shërbimin Civil dhe në kuptim të aktgjykimit të potencuar si më lartë si dhe bazuar në atë që u tha si më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se Ligji nr.06/L-114 për Zyratet Publike nuk zbatohet në raport me Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë, dhe rrjedhimisht Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në raport me Komisionin e Pavarur të Mediave, kishte mbetur në fuqi, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit material është i pa bazuar.

Duke qenë se procedura e rekrutimit për pozitën Kryeshef Ekzekutiv në kuadër të Komisionit të Pavarur për Media është zhvilluar në kuadër të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me pozitën e kategorisë së lartë drejtuese, e që nënkupton se mandati i këtyre pozitave sipas këtij ligji ka qenë me mandat tre (3) vjeçar, mirëpo sipas Vendimit me numër reference Nr.ref.1909/1054/KPM/mf të datës 16.09.2019 të nxjerr nga Kryetari i Komisionit të Pavarur i Mediave, ankuesi është emëruar në pozitën Kryeshef Ekzekutiv në kuadër të Komisionit të Pavarur për Media për një mandat katër (4) vjeçar.

Ndërsa sa i përket shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe vendimit të kundërshtuar me ankesë, i cili pretendon se rasti është i gjykuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe se asnjë rrethane nuk ka ndryshuar në raport me rastin e tij, Kolegji i Këshillit, në bazë të dëshmive të ofruara ka gjetur se Komisioni i Pavarur i Mediave duke marrë parasysh faktin se ndaj ankuesit me datë 13.09.2021 është ngritur aktakuzë me numër PP.I.39K/2021 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Renda, lidhur me kryerjen e veprës penale nga neni 421 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me datë 15.12.2021 ka nxjerr Vendim me numër Ref.2112/1460/KPM/xh.l për pezullimin e ankuesit nga ushtrimi i detyrave të punës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pas ankesës së parashtruar nga ankuesi kundër vendimit të lartpërmendur ka nxjerr Vendim A.nr.1212/2021 të datës 07.02.2022, përmes së cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit dhe ka lënë në fuqi Vendimin me Nr. Ref.2112/1460/KMP/xh. të datës 15.12.2021 për pezullim me 50% të pagës, e që ky proces domosdoshmërisht ndërlikohet me mandatin e zyrtarit të nivelit të lartë drejtues, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me përfundimin e mandatit, ndërsa në rastin kur është vendosur nga Këshilli me Vendimin A.nr.1212/2021 të datës 07.02.2022, kishte të bënte me çështje të pezullimit sipas detyrës zyrtare e që rrjedhimisht ndërlikohet edhe me çështje të mandatit në këso raste, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në raport me vendimin e kontestuar për shkak të shkeljeve materiale, është i pabazuar dhe nuk mund të konsiderohet që rasti është i gjykuar

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, konstaton se meqë pozitën e kategorisë së lartë drejtuese, në këtë rast pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media është pozitë me mandat, andaj në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit mandati i ankuesit sipas Vendimit me numër reference Nr.ref.1909/1054/KPM/mf të datës 16.09.2019 (pa hyrë në vlerësim të ligjshmërisë së këtij vendimi) të nxjerr nga Kryetari i Komisionit të Pavarur i Mediave, me kalimin e kësaj kohe është konsumuar, konstatim ky i cili gjënë mbështetje edhe në vlerësimin e Gjykatës së Apelit

të dhënë në Aktgjykimin AA.nr.403/2016 të datës 05.11.2019 me rastin e vendosjes për çështje me objekt të njëjtë, ku është konstatuar se: "...sipas nenit 15 par 3 të Ligjit për Shërbimin Civil mandati për pozitën e nivelit të lartë drejtues janë me afat të caktuar tre vjeçar. Ndërsa sipas nenit 90 par 2 dhe 3 të Ligjit për shërbimin civil rregullohet mënyra e përfundimit të marrëdhënies së punës sipas kontratës me afat të caktuar, e që marrëdhënia e punës përfundon me skadimin e kontratës së punës", rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se mandati për të cilin është emëruar ankuesi, për shkak të kalimit të kohës është konsumuar, andaj pretendimi ankimor për vazhdimin e pagesës me 50% të pagës si dhe anulimin e Vendimit me numër reference Nr.ref. 2310/970/EXD/fr të datës 23.10.2023 të Zëvendësuesit të Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur të Mediave është i pa bazuar, sepse ankuesit i ka përfunduar mandati i rregullt si Kryeshef Ekzekutiv i Komisionit të Pavarur të Mediave, respektivisht sipas Kolegjit të Këshillit, në rastet kur nëpunësit që mbajnë këto pozita pezullohen nga marrëdhënia e punës sikurse në rastin e ankuesit, atëherë mandati konsiderohet i konsumueshëm, dhe ky mandat përfundon në momentin kur përfundon mandati për të cilin është emëruar ankuesi sipas legjislacionit në fuqi, andaj lidhur me lëndë për çështje me objekt dhe natyrë të njëjtë gjegjësisht konsumimit të mandatit për pozitën e larta drejtuese Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur me Vendimin me numër A 02/112/2016 dhe Vendimin me numër A.nr.538/2021, të cilat mbështeten edhe sipas Aktgjykimit AA.nr.403/2016 të datës 05.11.2019 i Gjykatës së Apelit të Kosovës i cili aktgjykim është në një linjë me vendimmarrjen e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sa i përket kësaj çështje juridike-administrative, si rrjedhojë pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1377/2023

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI
Malsore Gashi-Bajraktari
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komisionit të Pavarur për Media;
- Njësisë për Burime Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Media; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

